



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 813/ 8 prot.

Datë 15.04.2026

V E N D I M

Nr. 504 / 2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e dates 15.04.2026 shqyrtoi kërkesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE Albsig Jetë, Sh.A, SIGAL Insurance Group, Sh.A, SIGAL LIFE Insurance Group, Sh.A, në procedurën e prokurimit “*E hapur, e thjeshtuar*”, me REF-76617-02-18-2026, me objekt: “Sigurimi i jetës dhe shëndetit të punonjësve të AAC”, me fond limit 3,524,640 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 02.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara Sh.A.

Ankimues: BOE Albsig Jetë, Sh.A, SIGAL Insurance Group, Sh.A, SIGAL LIFE Insurance Group, Sh.A, me NIPT-e L92019017V, J91809007H, K51423801Q, *adresa: Downtown One, Bulevardi: Bajram Curri , HQ 1010, Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Përqëndruara Sh.A.
Adresa:Rr. Reshit Çollaku”, godina nr.6/337, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për*

Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 19.02.2026, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me REF-76617-02-18-2026, me objekt: “Sigurimi i jetës dhe shëndetit të punonjësve të AAC”, me fond limit 3,524,640 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 02.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara Sh.A.

II.2. Në datën 02.03.2026, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt - shqyrtimi.

II.3 Në datën 04.03.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike përkatësisht:

1. BOE, Albsig Jetë, Sh.A, SIGAL Insurance Group, Sh.A,
SIGAL LIFE Insurance Group, Sh.A me ofertë 3,504,000 Lek Skualifikuar

II.4. Në datën 05.03.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar Anulimin e procedurës së prokurimit, në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

II.5. Njëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike, njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. Elektronik A/2026/6412, datë 12.03.2026 dhe me nr.813/2026 prot, datë 13.03.2026 e BOE Albsig Jetë, Sh.A, SIGAL Insurance Group, Sh.A, SIGAL LIFE Insurance Group, Sh.A, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me REF-76617-02-18-2026, me objekt: “Sigurimi i jetës dhe shëndetit të punonjësve të AAC”, me fond limit 3,524,640 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 02.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, Sh.A.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi Formularin për publikim, nr. 813/1 prot, datë 13.03.2026, lidhur me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

Me arsyet e skualifikimit:

-OE “Albsig Jetë” Sh.A me NUIS L92019017V nuk përmbush kërkesën e pikës 2.1 të Kriterit të Veçantë të Kualifikimit, lidhur me disponimin e “Licencës të vlefshme për Ushtrimin e Veprimtarisë së Sigurimit jetë dhe jo-jetë, në territorin e RSH, lëshuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare, sipas Ligjit 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”. Bazuar në kontratën e bashkëpunimit nr. Repertori 894, nr. Koleksioni 510, datë 26.02.2026 OE “Albsig Jetë” sh.a me NUIS L92019017V ka marrë përsipër të realizojë 70% për rrezikun e sigurimit të Jetës sipas licencës dhe 70% për rrezikun e sigurimit të Shëndetit sipas licencës. Referuar dokumentacionit të paraqitur, rezulton se OE “Albsig Jetë” sh.a me NUIS L92019017V disponon “LICENCË PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË SIGURIMIT” Nr. 13, datë 13.09.2019 “Për të ushtruar veprimtari sigurimi jete, në territorin e Republikës së Shqipërisë”.

Në konkluzion, ky operator ekonomik nuk disponon Licencë “Për të ushtruar veprimtari sigurimi jo-jetë” duke mos përmbushur në këto kushte detyrimin që ka marrë përsipër për realizimin në masën 70% të sigurimit të shëndetit.

-BOE nuk ka plotësuar në mënyrë korrekte ofertën ekonomike, pasi referuar ofertës së paraqitur (ndarja e riskut sipas kompanive), rezulton se OE “Albsig Jetë” sh.a me NUIS L92019017V ka marrë përsipër të realizojë primin e shëndetit (për të cilin nuk disponon Licencën përkatëse), në vlerën 2,207,520 lekë. Referuar parashikimeve ligjore në fuqi për primin e shëndetit duhej të ishte përllogaritur edhe taksa prej 10%, siç është përllogaritur për vlerën e paraqitur nga OE “SIGAL Insurance Group” ShA me NUIS J91809007H.

II.7. Me shkresën ardhur në sistem, me nr. 795/6 prot., datë 18.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 813/2, datë 18.03.2026, dhe me shkresën ardhur me postë me nr. 795/7 prot., datë 18.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 813/3, datë 19.03.2026, Autoriteti Kontraktor ka përcjellë Vendimin e KSHA-së në lidhje me shqyrtimin e ankesës, referuar të cilit ka vendosur: Mospranim të pretendimeve të ankesës.

II.8. Me shkresën me nr. 813/4, datë 30.03.2026, me objekt, Kërkesë për informacion, drejtuar Autoriteti të Mbikëqyrjes Financiare, Komisioni kërkoi si vijon:

[...] Në kuadër të shqyrtimit të një ankese për një procedurë prokurimi me objekt: “Sigurimi i jetës dhe shëndetit të punonjësve të AAC” rezulton se një nga pretendimet e paraqitura është si më poshtë vijon:

“[...] OE “Albsig Jetë” Sh.A me NUIS L92019017V nuk përmbush kërkesën e pikës 2.1 të Kriterit të Veçantë të Kualifikimit, lidhur me disponimin e “Licences të vlefshme për Ushtrimin e Veprimtarisë së Sigurimit jetë dhe jo-jetë, në territorin e RSH,” lëshuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, sipas Ligjit 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”

OE “Albsig Jetë” Sh.A me NUIS L92019017V disponon “LICENCË PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË SIGURIMIT” Nr. 13, datë 13.09.2019 “Për të ushtruar veprimtari sigurimi jete, në territorin e Republikës së Shqipërisë”..... ky operator ekonomik nuk disponon Licencë “Për të ushtruar veprimtari sigurimi jo-jetë” [...].”

Sa më sipër, për një gjykim sa më të drejtë të çështjes, Komisioni Prokurimit Publik kërkon nga ana juaj, si organi administrative kompetent në fushën e veprimtarisë mbi rregullimin dhe mbikëqyrjen: e tregut të sigurimeve dhe operatorëve të tij, bazuar në Ligjin Nr.52, datë 22.05.2014 “Për Veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, të na informoni mbi licencën me këto të dhëna:

Licencë Nr. 13, datë 13.09.2019 e Soqërisë “Albsig Jetë” Sh.A, regjistruar me Nipt L92019017V, në mbështetje të Vendimit të Bordit të AMF-së, nr.17, datë 13.09.2017 ushtron veprimtari sigurimi jete, në klasat :

Klasa 19: Sigurim Jetë-Vdekje

Klasa 20: Sigurim Martese-Lindje

Klasa 21: Sigurim jete i lidhur me fondet e investimi

Klasa 22: Sigurim i administrimit të fondeve kolektive

Klasa 23: Sigurim shtesë.

Kjo Licencë mbulon apo jo objektin e prokurimit “Sigurimi i jetës dhe shëndetit të punonjësve” sipas listës së shërbimeve të specifikuar në DST. [...]

II.9. Me shkresën Kthim përgjigje, protokolluar pranw KPP-së, me nr. 813/5, datë 08.04.2026, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare informon mbi kërkesën sipërcituar në lidhje me Licencën e operatorit ekonomik ankimues.

[...] Referuar mbulimeve të specifikuar në policën e sigurimit “Sigurimi i jetës dhe shëndetit të punonjësve”, rezulton se, mbulimi për humbjen natyrore të jetës përfshihet në “Klasën 19, nënklasat 19.1” ndërsa mbulimet e tjera të lidhura me kontratën e sigurimit të jetës, janë të përcaktuara në klasaën 23, “Sigurimi shtesë”, sipas Aneksit I, nënndarjea B, të Ligjit nr. 52/2014, “Për Veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”,

23. Sigurimi shtesë, i cili lidhet me kontratën e sigurimit të jetës, duke përfshirë një ose më shumë nga kombinimet e mëposhtme:

a) vdekje si rezultat i aksidentit;

b) paaftësi e përhershme në punë ose aftësi e kufizuar në punë, ose një lloj i caktuar dëmtimi si rezultat i një aksidenti;

c) paaftësi e përhershme në punë ose aftësi e kufizuar në punë, ose një lloj i caktuar dëmtimi si rezultat i një sëmundjeje;

ç) paaftësi e përkohshme si rezultat i një aksidenti;

d) paaftësi e përkohshme si rezultat i një sëmundjeje;

- dh) paaftësi për të kryer profesionin apo punën si rrjedhojë e dëmtimeve trupore;
- e) shërbimet spitalore;
- ë) sëmundjet e pashërueshme;
- f) shërbimet mjekësore.

Përsa më sipër, mbulimet e policës së sigurimit “Sigurimi i jetës dhe shëndetit të punonjësve” përfshihen në klasat e sigurimit 19 dhe 23, sipas licencës së dhënë shoqërisë së sigurimit “Albsig Jetë” Sh.A. [...].

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit të dosjes,

Arsyeton

III.1. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, mbi kundëshkrimin e arsyes së skualifikimit si më poshtë:

-OE “Albsig Jetë” Sh.A me NUIS L92019017V nuk përmbush kërkesën e pikës 2.1 të Kriterit të Veçantë të Kualifikimit, lidhur me disponimin e “Licencës të vlefshme për Ushtrimin e Veprimtarisë së Sigurimit jetë dhe jo-jetë, në territorin e RSH, lëshuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare, sipas Ligjit 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”. Bazuar në kontratën e bashkëpunimit nr. Repertori 894, nr. Koleksioni 510, datë 26.02.2026 OE “Albsig Jetë” sh.a me NUIS L92019017V ka marrë përsipër të realizojë 70% për rrezikun e sigurimit të Jetës sipas licencës dhe 70% për rrezikun e sigurimit të Shëndetit sipas licencës. Referuar dokumentacionit të paraqitur, rezulton se OE “Albsig Jetë” sh.a me NUIS L92019017V disponon “LICENCË PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË SIGURIMIT” Nr. 13, datë 13.09.2019 “Për të ushtruar veprimtari sigurimi jete, në territorin e Republikës së Shqipërisë”.

Në konkluzion, ky operator ekonomik nuk disponon Licencë “Për të ushtruar veprimtari sigurimi jo-jetë” duke mos përmbushur në këto kushte detyrimin që ka marrë përsipër për realizimin në masën 70% të sigurimit të shëndetit.

- BOE nuk ka plotësuar në mënyrë korrekte ofertën ekonomike, pasi referuar ofertës së paraqitur (ndarja e riskut sipas kompanive), rezulton se OE “Albsig Jetë” sh.a me NUIS L92019017V ka marrë përsipër të realizojë primin e shëndetit (për të cilin nuk disponon Licencën përkatëse), në vlerën 2,207,520 lekë. Referuar parashikimeve ligjore në fuqi për primin e shëndetit duhej të ishte përllogaritur edhe taksa prej 10%, siç është përllogaritur për vlerën e paraqitur nga OE “SIGAL Insurance Group” ShA me NUIS J91809007H.

III.1.1. Autoriteti Kontraktor ka publikuar në SPE, Shtojcën 6, Specifikimet Teknike si më poshtë:

Shtojca 6 .

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

“Sigurimi i jetës dhe shëndetit të punonjësve të Autoritetit të Aviacionit Civil”

Numri i punonjësve të pritshëm që do t’u mbulohej përfitimet dhe shpenzimet për sigurimin e jetës dhe shëndetit është 96 punonjës.

Sipërmarrësi duhet të ofrojë përfitimin për humbjen e jetës dhe mbulimin e shpenzimeve të problemeve të shëndetit sipas të dhënave të skemës së mëposhtme:

SIGURIMI I JETËS DHE SHËNDETIT

MBULIMI	PËRFITIMI
SHUMA E SIGURIMIT	2,000,000 lekë
SIGURIMI I JETËS DHE AKSIDENTIT PERSONAL	Limiti i mbulimit 600,000 lekë
Zona e mbulimit	Në të gjithë botën
Humbja Aksidentale e Jetës	600,000 lekë
Humbja Natyrore e Jetës	600,000 lekë
Paaftësia e Përhershme e Plotë	600,000 lekë
Paaftësia e Përhershme e Pjesëshme	Në % sipas dëmtimeve deri në 600,000 lekë
SIGURIMI I SHËNDETIT	Limiti i mbulimit 1,400,000 lekë
Zona e mbulimit	Shqipëri
Franshiza	1000 lekë
Trajtime mjekësore si pacient i shtruar në spital si pasojë e aksidentit apo sëmundjeve	
Dhoma dhe akomodimi në spital dhomë dyshe	100%
Shpenzimet për pagesën e mjekut specialistit, kirurgut, anezistit	100%
Përdorimi i pajisjeve dhe aparaturave të sallës së operacionit	100%
Kontrolle diagnostikuese, ekzaminimet me RXT, CT skaner, MRI skaner, PET skaner, ekografitë	100%
Kujdesi Intensiv	100%
Ndërhyrje kirurgjikale	100%
Trajtimi në sallën e emergjencës	100%
Reanimacion	100%
Ilaçet dhe medikamente mjekësore për përdorim në spital, si edhe gjaku plazma e oksigjeni	100%
Proteza dhe pajisje mjekësore të ngjashme	100%
Kemioterapi dhe radioterapi	100%
Terapi fizike dhe rehabilitim	100%
2. Trajtime mjekësore si pacient i jashtëm, pa shtrim në spital si pasojë e aksidentit apo sëmundjes deri në 120000 lekë	
Shpenzimet për konsultat me mjekun e përgjithshëm	100 %

Shpenzimet për mjekun specialist, si edhe teste diagnostikuese të rekomanduara nga mjeku	100%
Kontrolle diagnostikuese, ekzaminimet me RXT, CT skaner, MRI skaner PET skaner, ekografisë, shintigrafi	100%
Kirurgji ditore (mikrokirurgji pa shtrim në spital)	100%
Fizioterapi për rehabilitim pas aksidenteve të ndodhura brenda periudhës së sigurimit	100% deri në 20,000 lekë në vit
Receta mjekësore, medikamente mjekësore me princip aktiv të rekomanduara nga mjeku	100% deri në 20,000 lekë në vit
Përfitime të tjera në rast aksidenti dhe sëmundje	
Transporti me ambulancë rrugore dhe helikopter në rast emergjence kur kërcenohet jeta	100%
Trajtime dentare si pasojë e aksidentit	60,000 lekë
Ndërhyrja kirurgjikale e kryer në një spital publik.	50% e vlerës së ndërhyrjes në spital privat
Kimioterapi dhe radioterapi	100%
Kujdesi Parandalues Check-Up një herë në vit	
FEMRA	MESHKUJ
Gjak komplet	Gjak komplet
Urinë Komplet	Urinë Komplet
Lipidograma	Lipidograma
SGPT	SGPT
SGOT	SGOT
Glicemia	Glicemia
Azotemi	Azotemi
Kreatinemia	Kreatinemia
Bilirubinë totale	Bilirubinë totale
PAP-TEST	Grafi Pulmoni
Echo Abdominale	Echo Abdominale
Echo Gjiri	Echo Zemre
Konsultë Pathologu	Konsultë Pathologu
Echo Zemre	Vizitë Okulistike

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Mbulimi i shpenzimeve mjekësore si pasojë e gjendjeve mjekësore pre-ekzistuese

Kontrata e sigurimit do të mbulojë ndodhjen e ngjarjes së sigurimit për punonjësit të cilët kanë probleme mjekësore pre-ekzistuese. Me sëmundje pre-ekzistuese kuptohen sëmundje dhe gjendje mjekësore që janë shfaqur apo diagnostikuar përpara fillimit të sigurimit.

Gjendjet mjekësore pre-ekzistuese të mbulohen nga kompania e sigurimit në masën 70% dhe nga i siguruari në masën 30%.

Limitet vjetore të mbulimeve për të siguarit që kërkojnë trajtime për gjendje mjekësore pre-ekzistuese janë si më poshtë:

SIGAL Insurance Group, Sh.A dhe SIGAL LIFE Insurance Group, Sh.A të cilët emërojnë përfaqësues të posaçëm **Albsig Jetë Sh.A.**

2. Kontratë – Bashkëpunimi, operatorësh ekonomikë, për qëllim pjesmarrje në tenderin e Operatorit të Blerjeve të Përqendruara Sh.A.

Nr. Rep 894,

Nr. Kol 510,

datë 26.02.2026

1. Bashkësigurimi sipas përqindjeve të përcaktuara me poshtë do të shtrijë efektet ekonomike si në ndarjen e primit të sigurimit, që do të paguhet nga subjekti i siguruar, ashtu edhe në rast ndodhje të një ngjarje sigurimi. Gjithashtu janë parashikuar e dakortësuar shpenzime për marrjen në sigurim dhe trajtimin e sakte të dëmeve, të cilat do të paguhet nga secila kompani më vehte. Këto shpenzime do të mbulohen nga shoqëritë bashkim operatorësh në këtë kontratë, sipas riskut që është përcaktuar në nenin 2 më lart.

2. Pavarësisht nga kërkesa e Autoritetit Kontraktor, për lëshimin ose jo të faturës përkatëse tatimore nga kryesuesi shoqëria **ALBSIG JETE SH.A.**, për vlerën e primit në total, shoqëria **SIGAL Insurance Group SH.A dhe SIGAL LIFE Insurance Group SH.A** do të lëshojnë fature tatimore në çdo rast kundrejt, **ALBSIG JETE SH.A.**, për primin që i takon sipas ndarjes me poshtë:

- i. **ALBSIG JETE SH.A.** 70,00% (për rrezikun e sigurimit të Jetës sipas licencës)
70,00% (për rrezikun e sigurimit të Shëndetit, sipas licencës)
- ii. **SIGAL Insurance Group SH.A.** 30,00% (për rrezikun e sigurimit të Shëndetit, sipas licencës)
- iii. **SIGAL LIFE Insurance Group SH.A** 30,00% (për rrezikun e sigurimit të Jetës sipas licencës)

3. LICENCË lëshuar nga AMF, PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË SIGURIMIT

Nr. 13, datë 13.09.2019,

LICENCON

SHOQËRINË "ALBSIG JETË" SH.A.

"Për të ushtruar veprimtari sigurimi jete, në territorin e Republikës së Shqipërisë"

ANEKS

LICENCA NR. 13, DATË 13.09.2019 E SHOQËRISË "ALBSIG JETË" SH.A.

Shoqëria e sigurimit "ALBSIG JETË" sh.a, e regjistruar në QKR me NIPT L92019017V, në mbështetje të Vendimit të Bordit të AMF-së nr. 171, datë 13.09.2019, do të ushtrojë veprimtari sigurimi jete, në këto klasa sigurimi:

Klasa 19:	Sigurim Jetë - Vdekje
Klasa 20:	Sigurim Martesë - Lindje
Klasa 21:	Sigurim jete i lidhur me fondet e investimit
Klasa 22:	Sigurim i administrimit të fondeve kolektive
Klasa 23:	Sigurim shtesë.

4. LICENCË lëshuar nga AMF, PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË SIGURIMIT
Nr. 11/2004, datë 22.06.2012,

Si vijon:

LICENCON

SHOQËRINË "SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA" SH.A.
"Për të ushtruar veprimtari sigurimi jete, në territorin e Republikës së Shqipërisë"

ANEKS

LICENCA NR. 11/2004, DATË 22.06.2012 E SHOQËRISË "SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA" SH.A.

Shoqëria e sigurimit "SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA" sh.a, e rregjistruar në QKR me NIPT K51423801Q, në mbështetje të Lejes për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë në sigurime, nr. 11/1, datë 10.09.2004, do të ushtrojë veprimtari sigurimi jete, në këto klasa sigurimi:

- Klasa 19: Sigurim Jetë - Vdekje
- Klasa 20: Sigurim Martese - Lindje
- Klasa 21: Sigurim jete i lidhur me fondet e investimit
- Klasa 22: Sigurim i administrimit të fondeve kolektive

Sigurime aksesore:

- Klasa 1: Sigurimi i aksidenteve (përfshirë plagosjet industriale dhe sëmundjet profesionale)
- Klasa 2: Sigurimi i sëmundjeve

5. LICENCË lëshuar nga AMF, PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË SIGURIMIT

Nr. 2/1999, datë 22.06.2012,

LICENCON

SHOQËRINË "SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA" SH.A.

"Për të ushtruar veprimtari sigurimi jo-jetë, në territorin e Republikës së Shqipërisë"

ANEKS

LICENCA NR. 2/1999, DATË 22.06.2012 E SHOQËRISË "SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA" SH.A.

Shoqëria e sigurimit "SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA" sh.a, e rregjistruar në QKR me NIPT J91809007H, në mbështetje të Lejes për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë në sigurime, nr. 2/1, datë 28.06.1999, do të ushtrojë veprimtari sigurimi jo-jetë, në këto klasa sigurimi:

- Klasa 1: Sigurimi i aksidenteve (përfshirë plagosjet industriale dhe sëmundjet profesionale)
- Klasa 2: Sigurimi i sëmundjeve

6. Dokumenti Shtojca 1, Formulari i Ofertës , datë 02.03.2026, Lëshuar nga ALBSIG Jetë Sh.A përfaqësues I Bashkimit të operatorëve ekonomikë.

III.1.3. Në nenin 77, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III. 1.4. Në nenin 41, *Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve*, pikat 1,2, 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.

2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;

Neni 88, *Bashkimi i operatorëve ekonomikë*, i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se:

1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.
3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.
Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.
4. Operatori ekonomik, anëtar i një bashkimi, nuk mund të paraqesë njëkohësisht edhe oferta individuale. Bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk ndryshon pas dorëzimit të ofertës, në të kundërt oferta e tij refuzohet. Autoriteti ose enti kontraktor, para lidhjes së kontratës, mund të kërkojë që bashkimi i operatorëve ekonomikë të krijohet zyrtarisht me një marrëveshje të noterizuar.
5. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.
6. Në rast falimentimi të një prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë ose në rrethana të tjera, që ndërpresin veprimtarinë e tij gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor mund të vazhdojë kontratën me operatorin/ët e tjerë ekonomikë, anëtarë të bashkimit, me kusht që ai të zotërojë kapacitetet ligjore, ekonomike, financiare dhe teknike për të zbatuar kontratën. Përndryshe, autoriteti/enti kontraktor zgjidh kontratën.

III.1.5. Me shkresën: Kthim përgjigje, protokolluar pranë KPP-së, me nr. 813/5, datë 08.04.2026, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare informon mbi kërkesën e Komisionit dërguar me shkresën Nr. 513/4 prot., datë 30.03.2026, sipërcituar në pikën II.9, në lidhje me Licencën e operatorit ekonomik ankimues.

[...] Referuar mbulimeve të specifikuara në policën e sigurimit “Sigurimi i jetës dhe shëndetit të punonjësve”, rezulton se, mbulimi për humbjen natyrore të jetës përfshihet në “Klasën 19, nënklasat 19.1” ndërsa mbulimet e tjera të lidhura me kontratën e sigurimit të jetës, janë të përcaktuara në klasaën 23, “Sigurimi shtesë”, sipas Aneksit I, nënndarjea B, të Ligjit nr. 52/2014, “Për Veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”,

23. Sigurimi shtesë, i cili lidhet me kontratën e sigurimit të jetës, duke përfshirë një ose më shumë nga kombinimet e mëposhtme:

a) vdekje si rezultat i aksidentit;

- b) paaftësi e përhershme në punë ose aftësi e kufizuar në punë, ose një lloj i caktuar dëmtimi si rezultat i një aksidenti;
- c) paaftësi e përhershme në punë ose aftësi e kufizuar në punë, ose një lloj i caktuar dëmtimi si rezultat i një sëmundjeje;
- ç) paaftësi e përkohshme si rezultat i një aksidenti;
- d) paaftësi e përkohshme si rezultat i një sëmundjeje;
- dh) paaftësi për të kryer profesionin apo punën si rrjedhojë e dëmtimeve trupore;
- e) shërbimet spitalore;
- ë) sëmundjet e pashërueshme;
- f) shërbimet mjekësore.

Përsa më sipër, mbulimet e policës së sigurimit “Sigurimi i jetës dhe shëndetit të punonjësve” përfshihen në klasat e sigurimit 19 dhe 23, sipas licencës së dhënë shoqërisë së sigurimit “Albsig” Jetë” Sh.A. [...].

III.1.6. Referuar legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi përsa kohë i kanë pranuar ato.

Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjithë kriteret për kualifikim, termat e references të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejte me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat që duhet të ndiqen për për zgjedhjen e ofertës më të mirë, në kuptim të këtij ligji.

III.1.7. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues, K.P.P. konstaton se, ka paraqitur në SPE dokumentet e ofertës në përmbushje të kritereve kualifikuese, si më sipër cituar në pikën III.1.2, përkatësisht: Kontratën e Bashkëpunimit në brendi të së cilës konstatohet se në nenin 2 të saj, Bashkësigurimi i riskut për tenderin e Operatorit të Blerjeve të Përqendruara është përcaktuar ndarja në përqindje midis operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në BOE.

- i. ALBSIG JETE SH.A. 70,⁰⁰% (për rrezikun e sigurimit të Jetës sipas licencës)
70,⁰⁰% (për rrezikun e sigurimit të Shëndetit, sipas licencës)
- ii. SIGAL Insurance Group SH.A. 30,⁰⁰% (për rrezikun e sigurimit të Shëndetit, sipas licencës)
- iii. SIGAL LIFE Insurance Group SH.A. 30,⁰⁰% (për rrezikun e sigurimit të Jetës sipas licencës)

Pra BOE ka përcaktuar saktësisht ndarjen në përqindje të riskut të sigurimit sipas Licencave të cdo anëtarit të BOE-së.

Referuar Dokumenteve të ofertës, Licencat e operatorëve ekonomikë cituar në pikën III.1.2.

III.1.8, Komisioni nga shqyrtimi i dokumenteve të dosjes konstatoi, se operatori ekonomik **Albsig Jetë Sh.A.** posedon **Licencë me Nr. 13, datë 13.09.2019, lëshuar nga AMF, për veprimtari sigurimi sipas Klasa 19: Sigurim Jetë-Vdekje,** si edhe **Klasat 20,21,22, dhe 23, Sigurim shtesë.**

Nga shqyrtimi i dokumenteve të ofertës së BOE-së konstatohet se ndarja e riskut konkret është një kërkesë e parashikuar në aktin normativ sipërcituar dhe është një faktor i rëndësishëm mbi të cilin autoriteti kontraktor bën verifikimin dhe shqyrtimin e përmbushjes kriteve të përcaktuar në dokumentat e tenderit, me dokumentacionin e paraqitur nga ana e operatorit ekonomik, në përputhje me përqindjen e kryerjes së shërbimit të sigurimit, marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit.

Në rastin konkret gjithashtu është përcaktuar përqindja e pjesmarrjes në bashkëpunim për secilin nga anëtarët e BOE-së në përputhje me Licencat përkatëse të secilit anëtar, dhe referuar dokumenteve të ofertës, Komisioni konstaton se Operatori ekonomik si subjekti i parë i interesuar në plotësimin e dokumenteve të tenderit, ka paraqitur Licencat më qëllim që oferta e tij të rezultojë e vlefshme duke vërtetuar se i përmbush të gjitha kriteret dhe kërkesat e vendosura nga autoriteti kontraktor.

KPP gjykon se BOE ankimues në përmbushje të detyrimeve në përputhje me Kontratën e Bashkëpunimit, të deklarojë në SPE dokumentacionin e nevojshëm Marreveshjen e Bashkëpunimit si edhe Licencat përkatëse për realizimin e procedurës së prokurimit përsa kohë i ka pranuar dokumentet e procedurës së prokurimit. Komisioni konstaton se operatori ekonomik ka paraqitur në SPE të gjitha Licencat e operatorëve ekonomikë pjesmarrës në BOE, në përmbushje të kërkesave të AK-së, listuar më sipër, pjesë e ofertës së ankimuesit.

Gjithashtu duke u kthyer tek ankesa e paraqitur në lidhje me vlerësimin e procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi dhe pretendimet mbi kundërshtimin e skualifikimit nga autoriteti kontraktor të ankimuesit: [...] *Nuk ka Licencën përkatëse në përmbushje të detyrimit të tij mbi 70% të riskut të sigurimit të shëndetit*, Komisioni i Prokurimit Publik, për një shqyrtim objektiv dhe bazuar në dokumente konkrete listuar më sipër si edhe në komunikimin me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, ka marrë informacionin e kërkuar cituar i plotë në pikën III.1.5.b ku në konkluzionin e shkresës specifikisht citohet: [...] ***Përsa më sipër, mbulimet e policës së sigurimit “Sigurimi i jetës dhe shëndetit të punonjësve” përfshihen në klasat e sigurimit 19 dhe 23, sipas licencës së dhënë shoqërisë së sigurimit “Albsig Jetë” Sh.A. [...].***

Përsa konstatuar dhe në analizë të fakteve, referuar Ligjit 52/2024 i ndryshuar si edhe Informacionit më sipër, të Autoritetin të Mbikëqyrjes Financiare, Komisioni gjykon se dokumente e ofertës së ankimuesit rezultojnë të plota në tërësi dhe në veçanti Licenca e operatorit ekonomik ankimues, “Albsig Jetë” Sh.A është e vlefshme përsa i përket mbulimit të Sigurimit të jetës dhe shëndetit të punonjësve të AAC, duke përmbushur objektin e procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi. Gjithashtu Komisioni, përsa argumentuar mësipër gjykon se Vendimi i KVO-së mbi arsyen e skualifikimit objekt ankimi, nuk është i drejtë.

Përsa argumentuar pretendimet e operatorit ekonomik qëndrojnë.

III.2. Në lidhje me pretendimet e ankimuesit mbi kundërshtimin e arsyes së skualifikimit :

- BOE nuk ka plotësuar në mënyrë korrekte ofertën ekonomike, pasi referuar ofertës së paraqitur (ndarja e riskut sipas kompanive), rezulton se OE “Albsig Jetë” sh.a me NUIS L92019017V ka marrë përsipër të realizojë primin e shëndetit (për të cilin nuk disponon Licencën përkatëse), në vlerën 2,207,520 lekë.

Referuar parashikimeve ligjore në fuqi për primin e shëndetit duhej të ishte përlllogaritur edhe taksa prej 10%, siç është përlllogaritur për vlerën e paraqitur nga OE “SIGAL Insurance Group” ShA me NUIS J91809007H.

Argumentuar ...oferta ekonomike e paraqitur reflekton aplikimin e taksës vetëm për pjesën që i takon shoqërisë së sigurimit jo-jetë në BOE. Në “Listën e Çmimeve” është shënuar se “Taksa 10% aplikohet vetëm për shoqëritë e sigurimit të Jo Jetës” si dhe është llogaritur taksa për primin e SIGAL Insurance Group SH.A., duke dalë çmimi total i ofertës. Kjo tregon se BOE nuk ka shmangur taksën, por e ka trajtuar sipas natyrës së pjesës përkatëse [...]

III.2.1. Neni 14 i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar: “Operatorët ekonomikë 1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë. 2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t’i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje. Autoritetet ose entet kontraktore mund t’u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t’u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës. 3. Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

Në nenin 92 /1 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

III.2.2. Neni 88, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, i VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

1. *Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.*
2. *Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.*
3. *Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.*
Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila

III.2.3 Autoriteti kontraktor ka publikuar në DST Shtojcën 2.

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë
(në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Data: _____

1	2	3	4	5	6
Shërbimi	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Numri i personave të siguruar	Vlera e mbulimit për person (lekë)	Primi vjetor për person pa taksë / (lekë)	Primi total vjetor pa taksë (lekë) 3 x 5
1.					
2.					
	Çmimi total				
Primi Neto pa Taksë					
Taksa (10 %)					
Primi total me Taksë:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

III.2.4. Në përmbushje të **Shtojca 2**, Formulari i Ofertës Lista e Çmimeve e paraqitur nga BOE, rezulton Formulari i plotësuar me firmë e vulë nga operatori ekonomik përfaqësues Albsig Jetë SH.A. cituar më poshtë,

Lista e Çmimeve / ne LEKE

1	2	3	4	5	6
Shërbimi	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Numri i personave të siguruar	Vlera e mbulimit për person (lekë)	Primi vjetor për person pa taksë / (lekë)	Primi total vjetor pa taksë (lekë)
1	Sigurim i jetes dhe shendetit te punonjesve te AAC	96 (nentedhjeteeegjashte)	2,000,000	35,514.5	3,409,392
	Çmimi total				3,409,392
Primi Neto pa Taksë					3,409,392
Taksa (10 %) Taksa 10% aplikohet vetem per shoqerite e sigurimit te Jo Jetes pasi shoqerite e sigurimit te Jetes jane te perjashtuara nga aplikimii takses kombefare. Primi i SIGAL Insurance Group SH.A Primi Neto 851,472 + 94,608 Tax (10 %) = 946,080 Leke (primi total)					94,608
Primi total me Taksë:					3,504,000

1. *Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.*

III.2.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, publikimit të dokumenteve të tenderit me kriteret, kërkesat e vendosura me shtojcave përkatëse, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë duhet të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. I ndryshuar.

Në rastin konkret, nisur nga arsyeja e skualifikimit, si edhe nga verifikimet e dokumentacioneve të sipërcituara, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se BOE Albsig Jetë, SIGAL Insurance Group, SIGAL LIFE Insurance Group ka praqitur ofertën ekonomike në përputhje me shtojcën 2, sipërcituar në pikat III 2.1 e vijim duke plotësuar tabelën përkatëse si edhe në mbështetje të Kontratës së Bashkëpunimit në brendi të së cilës konstatohet se në nenin 2 të saj, Bashkësigurimi i riskut për tenderin e Operatorit të Blerjeve të Përqendruara është përcaktuar ndarja në përqindje. Nga shqyrtimi i formularit të ofertës konstatohet se operatori ekonomik ka përcaktuar taksën 10% shoqëruar me sqarime në ndarjen përkatëse. Gjithashtu referuar seksionit Kërkesa në SPE, operatori ekonomik ka përcjellë shkresën sqarim mbi arsyet e skualifikimit të ofertës së tij duke dhënë sqarime në lidhje me formulimin e ofertës ekonomike në kundërshtim të arsyes së skualifikimit. Nga dokumentet e dosjes rezulton se AK nuk ka marrë në shqyrtim shkresë e operatorit ekonomik.

Komisioni në analizë të fakteve thekson se në referim të nenit 92 pika 1 të *lex specialis* në të cilin përcaktohet se:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave.

Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.”, Autoriteti kontraktor për një shqyrtim të drejtë dhe objektiv të çështjes, pa cenuar përmbajtjen e ofertës dhe duke mos pasur si qëllim ndikimin në vlefshmërinë e tyre, sa herë lind nevoja për sqarime mbi ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, ka detyrimin ligjor që në mbështetje të nenit 92 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar t'i drejtohet me kërkesë për sqarim operatorëve ekonomikë, në përmbushje të qëllimeve të *lex specialis* të parashikuara në nenin 2 të tij. Me mosveprim e tij mbi kërkesën për sqarime mbi pasaktësi, autoriteti kontraktor i ka cenuar operatorit ekonomik mundësinë për të shteruar të gjitha alternativat e vënies në dispozicion të dokumenteve sqaruese, siç është në rastin konkret oferta ekonomike e ankimuesit ngarkuar në sistem, i cili do t'i krijonte një panoramë më të qartë autoritetit kontraktor mbi përmbushjen e detyrimeve dhe marrjen përsipër të zbatimit të kontratës, bazuar në Marrëveshjen e bashkëpunimit të BOE-së, mbi përmbushjen e objektit të prokurimit.

Duke qenë se autoriteti kontraktor referuar sistemit të prokurimit elektronik, informacionit të dërguar nga ai si pjesë e materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ, si dhe parashkrimeve të operatorit ekonomik ankimues, në kundërshtim me nenin 92, pika 1 të *lex*

specialis, nuk i ka kërkuar sqarim operatorit ekonomik ankimues me qëllim për përmbushjen saktë të formularit të ofertës, ku si rezultat e ka skualifikuar atë duke anashkaluar të drejtat e palëve për një proces ligjor dhe profesional.

Përsa argumentuar Komisioni gjykon se pretendimet e operatorit ekonomik qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga BOE Albsig Jetë Sh.A, SIGAL Insurance Group Sh.A, SIGAL LIFE Insurance Group Sh.A, për procedurën e prokurimit “*Procedure e Hapur e Thjeshtuar*”, me REF-76617-02-18-2026, me objekt: “Sigurimi i jetës dhe shëndetit të punonjësve të AAC”, me fond limit 3,524,640 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 02.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara Sh.A.
2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë procedurën e mësipërme të prokurimit duke kualifikuar BOE Albsig Jetë Sh.A, SIGAL Insurance Group Sh.A, SIGAL LIFE Insurance Group Sh.A sipas konstatimeve të këtij vendimi.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorit ekonomik Albsig Jetë, Sh.A.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

